



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 50/2014

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Nenad Lazic kryesues, Ferit Osmani dhe Rafet Haxhaj anëtarë, duke vendosur përkitazi me apelin e Jedinstvena Unija Goranaca (JUG) të përfaqësuar nga Adem Hoxha, paraqitur kundër vendimit me nr. 720/2014 të dt. 25.04.2014 të Komisionit Qendror Zgjedhor (KQZ), në seancën e panelit të mbajtur me 29.04.2014, mori këtë:

VENDIM

- I. **APROVOHET apeli** i Jedinstvena Unija Goranaca (JUG), **si i bazuar**.
- II. **ANULOHET** vendimi i Komisioni Qendror Zgjedhor (KQZ), me nr. 720/2014 të dt. 25.04.2014 dhe çështja kthehet në rishqyrtim.

Arsyetim

PZAP-i, ka pranuar një apel nga përfaqësuesi i JUG paraqitur kundër vendimit të KQZ-së me nr. 720/2014 të dt. 25.04.2014, me të cilin iu është refuzuar kërkesa për regjistrim e subjektit politik. Parashtruesi i apelit thekson se ky vendim është marr pa bazë dhe është i kundërligjshëm dhe kërkon nga PZAP që të anulohet këtë vendim.

Parashtruesi i apelit shton se e ka dorëzuar dokumentacionin e kompletuar i cili iu është kërkuar nga ZRPPC-ja brenda afatit prej 5 ditësh, afat të cilin i ka caktuar ZRPPC-ja dhe ata kanë kryer të gjitha plotësimet e kërkuara me shkresë zyrtare me nr. të protokollit 91/2014 të dt. 28.03.2014.

ZRPPC-ja i është përgjigjur pozitivisht lidhur me kërkesën për regjistrim dhe ka dhënë rekomandimin e saj në KQZ që të regjistroj Subjektin Politik JUG, ku në rekomandim nuk është dhënë asnjë sugjerim lidhur me ndërrimin e akronimit.

PZAP-i, në kuptim të nenit 4 paragrafi 3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, e informoi ZRPPC-në më datën 28.04.2014, për apelin që është bërë ndaj vendimit të KQZ-së dhe ka kërkuar që të përgjigjet ndaj apelit deri më datë 28.04.2014 deri në ora 13:00. PZAP-i, pranoi përgjigjen e kërkuar nga ZRPPC-ja, në të cilën theksohet se KQZ mbetet në tërësi pran vendimit të ankimuar bazuar në nenin 5.1 pika (c) të Rregullës Zgjedhore 01/2013 në të cilën theksohet se subjekti politik paraqitet për regjistrim me emër, akronim ose simbol që sipas vlerësimit të tyre mund të nxis urrejtje apo dhunë ndër etnike dhe religjioze, që në rastin konkret akronimi i subjektit në fjalë është konsideruar si nxitje.

ZRPPC ka bashkangjitur si dëshmi rekomandimin për regjistrim, vendimin e KQZ-së, dhe sugjerimet nga Zyra.

PZAP-i, pasi që shqyrtoi dhe analizoi shkresat e lëndës gjeti se:

apeli është i bazuar

PZAP-i, konstatoi se pretendimet ankimore të përfaqësuesit të subjektit politik Jedinstvena Unija Goranaca (JUG), janë të argumentuara në fakte dhe dëshmi konkrete pasi që apelit në fjalë pala i ka bashkangjitur dëshmi bindëse për Statutin dhe Programin e Veprimit Politik dhe se në të shihet qartë se nuk ka ndonjë shkelje të nenit 5 par.1 pika (c) të Rregullës 01/2013 të KQZ-së. Akronimi “JUG” i këtij subjekti politik ka kuptimin e tri shkronjave të para të subjektit politik Jedinstvena Unija Goranaca (JUG), gjë që ky akronim nuk asocon me asgjë tjetër.

Me vendimin e nr.720 të datës 25.04.2014 të KQZ-së, i është refuzuar kërkesa për regjistrimin e subjektit politik me arsyetim se akronimi i subjektit politik në fjalë është në kundërshtim më nenin 5 par.1 pika (c) e Rregullës nr. 01/2013.

PZAP-i, pas administrimit të provave konstatoi se apeli është i bazuar ngase KQZ lidhur më vendimin nr.720 të datës 25.04.2014, nuk e ka dhënë asnjë arsye pse akronimi i subjektit politik në fjalë është në kundërshtim më nenin 5 par.1 pika (c) e Rregullës nr.1/2013, andaj apeli vlerësohet si i bazuar, duke u bazuar në nenin 118 par. 1, neni 122 par.3 pika (a) të LZP-së dhe lidhur me nenin 209 pika (d) të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK) apeli i lartë përmendur u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Anr. 50/2014 më datën 29.04.2014.

Kryesuesi i Panelit

Nenad Lazic

Prishtinë / Pristina

Këshillë Juridike: Ndaj këtij vendimi mund të paraqitni ankesë në Gjykatën Supreme të Republikës së Kosovës brenda 24 orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.

